



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF
KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
Komiteti për Politikë dhe Financa
01 Nr.060-5456/2018
Gjakovë, me dt.12.04.2018, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e vogël

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa

Të pranishëm ishin këta anëtarë të KPF-së: z. Anton Shala, z. Haxhi Sejdi, znj. Florentina Gjergjaj, z. Bekim Jupa, z. Fazli Hoxha, znj. Diana Qarkaxhia, znj. Hana Zeka, z. Bekim Ermeni, z. Agon Batusha.

Të pranishëm të tjerë: z. Shkumbim Kastrati, z. Durim Halilaj, përfaqësuesja e ZKKK-së znj. Pranvera Kershaj, zyrtar për informim, përfaqësues të OSBE-së dhe të OJQ-ve, media lokale: TV Syri, Radio Gjakova, dhe media të shkruara.

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: **z. Anton Shala**.

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të pranishëm të Komitetit për Politikë dhe Financa sot do ta kemi mbledhjen e tretë për vitin 2018, të pranishëm në këtë mbledhje janë: 9, anëtarë, andaj me që ekziston kuorumi po fillojmë me mbledhjen.

Për këtë mbledhje është propozuar rendi i ditës, sipas ftesës të cilën e keni marrë, por kemi edhe një pikë shtesë për këtë mbledhje Informatën Financiare për periudhën Janar - Mars 2018, kjo vonesë ka ndeshur për shkak se janë vonuar disa të dhëna nga MEF-i, andaj propozojmë që kjo të jetë si pikë e 5 rendit të ditës, si dhe një njoftim se në mbledhjen e Kuvendit pritet që si pikë e rendit të ditës të kemi edhe kërkesën për binjakëzimin e Komunës së Gjakovës me komunën Forte Dodge të Lova USA, a ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim.

Kryesuesi: Meqenëse se nuk ka diskutime e qes në votim miratimin e rendit të ditës sipas ftesës që e keni marrë, si dhe të shtohet Informata Financiare Janar-Mars 2018, kush është: Për, Kundër, Abstenim.

Nga anëtarët e pranishëm unanimisht u votua pro miratimit të rendit të ditës sipas ftesës që e keni marrë.

Pas votimit të bërë u miratua ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 30.03.2018.
2. Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror.
3. Informate mbi menaxhimin e mbeturinave.
4. Informate mbi ndriçimin publik.
5. Informata e parë financiare Janar Mars 2018 .
6. Të Ndryshme .

1.Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 30.03.2018

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt.30.03.2018, andaj e hapi diskutimin, a ka dikush ndonjë vërejtje ose sugjerim sa i përket procesverbalit.

Kryesuesi: Pasi që nuk ka diskutime e qes në votim, miratimin i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt.30.03.2018, **Kush është Për, Kundër , Abstenim.**

Nga anëtarët e KPF-së unanimisht u votua pro këtij procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Pika e dytë e rendit të ditës: Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi shqyrtimi i Informatave mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror edhe kjo pikë është e paraparë në Planin e Punës së Kuvendit dhe e ftoj Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Shkumbim Kastrati që të merr fjalën .

z. Shkumbim Kastrati : Komuna e Gjakovës ne janar te vitit 2018 ka kontraktuar dy kompani për mirëmbajtje te rrugëve në zonën urbane dhe ne zonën rurale, me dt.20.01.2018, kemi filluar me lëshimin e urdhëresave dhe intervenim, ndërsa me intervenimet e fundit janë kryer me dt.22.03.2018 dhe 23.03.2018. Mirëmbajtja e rrugëve ne komunën e Gjakovës kryesisht ka qen e mirë edhe pse kemi pasur probleme ne fillimin te sezonit nga reshjet e bores sidomos ne zonat kodrinore dhe malore ku ne bazë të kontratës kanë çen 300 km rrugë për mirëmbajtje, andaj është e pamundur qe te veprohet paralelisht ne te gjitha këto segmente, mirëpo me angazhimin e madh kemi arritur qe me disa vonesa te vogla të intervenojmë ne te gjitha rastet, andaj mund te themi qe situata ka qenë e kënaqshme. Në të reshurat e muajit janar vlen te theksohet qe kemi pasur përkrahjen e Ministrisë se Infrastrukturës sidomos ne rajonin e Dushkajës ku kemi teren kodrinor - malor. Shpenzimet e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve ne gjithë sezonin kanë qenë rreth 60 mijë euro.

z. Agon Batusha: Fillimisht e falënderoj Drejtorin për prezantimin e këtij raporti, i cili është prezantuar për here te parë ne komunën e Gjakovës, problematika qe e ka përcjell komunën vazhdimisht është se tenderët janë hapur me vonës, andaj unë dua të bëj pyetje lidhur me kontratën qe është nënshkruar në janar se për çfarë periudhe kohore vlen kjo kontratë.

z. Shkumbin Kastrati: Kjo është kontratë kornizë, që bazohet në bazë të vlerës së paraparë e cila është e paraparë për dy vite, mirëpo nëse e tejkalon vlerën kontrata përfundon dhe sipas gjitha gjasave në muajin gusht do të fillojnë procedurat për kontratën e re, sepse nuk guxojmë të lejojmë që të kalohet mbi 30% e vlerës së kontratës.

Kryesuesi: Unë mendoj që kemi qenë me fat pasi që nuk ka pasur reshje bore në fillim të këtij viti, sepse do të kishim hasur në probleme të mëdha duke pasur parasysh që kemi pasur vit zgjedhor, andaj unë kam një pyetje lidhur me kompanitë që e kanë të nënshkruar kontratën se a i posedojnë makineritë e nevojshme duke pasur parasysh tërë territorin e Gjakovës.

z. Shkumbin Kastrati: Ligji i ka të caktuara kriteret në bazë të cilave duhet të zgjidhet një kompani, duke u bazuar në bazë të kilometrave dhe specifikave të kërkuara nga Drejtoria, pra këto kompani i plotësojnë këto kushte dhe ju lejohej që të kenë edhe nënkontraktor të tjerë.

z. Agon Batusha: U tha nga Drejtori se para lidhjes së kontratës është mobilizuar KRM-Çabrati dhe me sa kam informata është furnizuar edhe me krip, andaj pas lidhjes së kontratës me kompanitë si do të veprohet me atë furnizim të çabratit.

z. Shkumbin Kastrati: KRM-Çabrati është ndërmarrje publike dhe ka pavarësi financiare andaj mundet edhe të shes atë sasi të kripës.

Znj. Florentina Gjergjaj: Unë dua të bëj një pyetje lidhur me kriteret e nënkontraktorit se a ja vlejnë të njëjtat apo vlejnë kritere të reja.

z. Shkumbin Kastrati: Kriteret përcaktohen nga Drejtoria që hap tenderin, ndërsa nënkontraktoret janë nënkontraktor të kompanisë fituese, ndërsa komunën vetëm që e njoftojnë që kemi një kontraktor.

z. Haxhi Sejdiu: Lidhur me intervenimin e kompanisë për pastrimin e borës si është e rregulluar me kontratë, me sasi të borës së rënë apo kur duhet ajo të dalë në teren dhe si paguhet për ato intervenime.

z. Shkumbin Kastrati: Kompania paguhet në bazë të kilometrave në të cilat ajo ka intervenuar për pastrimin e borës dhe nuk paguhet nëse nuk intervenon dhe kur ka sasi të madhe të borës kompania duhet të jetë e përgatitur edhe për këtë situatë.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kalojë për diskutim në Mbledhjen e radhës së Kuvendit, nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I.** Aprovohet Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror.
- II.** Ky përfundim së bashku me materialin dhe dokumentin e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

3. Pika e tretë e rendit të ditës: Informate mbi menaxhimin e mbeturinave.

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave edhe kjo pikë është e paraparë në Planin e Punës së Kuvendit dhe e ftoj Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Shkumbin Kastrati që të merr fjalën.

z. Shkumbim Kastrati: Menaxhimi i mbeturinave është kompetencë e komunave sipas ligjit për menaxhimin e mbeturinave dhe ne shumicën e komunave ekzistojnë ndërmarrjet publike që merren me menaxhimin e mbeturinave dhe të ne ekziston KRM- Çabratit, tek ne në Drejtorinë e shërbimeve publike kemi planifikuar mjetet dhe jemi në procedurë të themelimit të sektorit për menaxhimin e mbeturinave, mirëpo ligji e parasheh edhe arkëtimin e mjeteve përmes drejtorisë së financave gjë që është e pamundur për momentin, sepse kërkohet një shumë e madhe mjeteve, andaj ne marrëveshjen me Ministrinë e Financave dhe me kërkesën për mirëkuptim edhe nga anëtarët e kaluar të kuvendit për mos atakimin e KRM- Çabratit, sepse nëse inkasimi i mjeteve bëhet përmes Drejtorisë së Financave atëherë edhe mirëmbajtja dhe menaxhimi i mbeturinave duhet të kalojë përmes tenderit të hapur publik dhe atëherë rrezikohen 120 vende të punës në KRM- Çabratit dhe kjo është arsyeja e kësaj gjendje edhe pse unë personalisht nuk jam i kënaqur me menaxhimin e mbeturinave. Në të kaluarën ka qenë një taks-force për kontrollimin dhe gjatë punës, mirëpo i ka skaduar mandati e tani është formuar një komision prej katër Drejtorive dhe një ndihmës e madhe është instalimi i 40 kamerave në qytet përmes të cilave janë identifikuar shumë shkelës ku kryesisht janë kompani private të cilat punojnë gjatë ditës dhe në mbrëmje hedhin mbeturinat në mënyrë ilegale.

Kryesuesi: Drejtoria për shërbime publike ka një sektor të gjerë të punëve mirëpo sektori i menaxhimit të mbeturinave është një nder sektorët me të ndjeshëm të një shoqërie dhe objektivisht ne duhet të fokusohemi në këtë sektor, sa i përket KRM- Çabratit, ne nuk po e fajësojmë këtë kompani dhe vazhdimisht kemi qenë të interesuar që të ndihmojmë në zgjerimin e fushëveprimit të tyre, ku ne disa fshatra është duke vepruar dhe është duke bërë një punë mjaft korrekte dhe kërkojmë nga Drejtoria për Shërbime Publike që të bëjë planifikimin për fshatra që nuk janë të mbuluara që të bëjë të mundur lidhjen e kontratave dhe grumbullimin e mbeturinave nga KRM- Çabratit, për arsye se kjo është edhe standard për integrim evropian. Ndërsa sa i përket atyre kompanive të cilat janë të pa ndërgjegjshme që janë identifikuar nga kamerat e qytetit të gjatë.

z. Agon Batusha: Edhe një herë dua ta cekim se është një hap përpara që kemi një raport për menaxhim të mbeturinave, ne gjithë e dimë se Çabratit e ka përgjithësinë kryesore për menaxhimin e mbeturinave pasi që është kompani publike, e tha edhe kryesuesi që menaxhimi i mbeturinave është edhe kriter për integrim evropian, por ku nuk pajtohem me Drejtorinë është se ky është një mendim personal se do të ishte me mirë kompanitë private ta menaxhonin Çabratin, por dua të shtoj se shumica dërrmuese e Bashkimit Evropian për menaxhimin e mbeturinave e bëjnë kompanitë publike të komunës. Po ashtu dua të cekim se Çabratit ka pasur përmirësim të menaxhimit por jo përmirësim të mjaftueshëm që do të thotë që punëtorët janë, resurset janë, ne kemi problem me menaxhimin, kjo është interes edhe i shoqërisë.

z. Haxhi Sejdiu: Në afërsi të urave po krijohen deponi të mbeturinave që shkaktojnë shumë probleme andaj duhet të gjejmë një zgjidhje qoftë edhe me vendosjen e kamerave, gjithashtu kërkoj që të merren masat dhe të sigurohen kontrata për gjithë qytetarët në mënyrë që të mos ketë hedhje ilegale të mbeturinave, pasi që banoret duhet të hedhin dikun ato mbeturina, gjithashtu kërkoj që kontonierët e hapur të zëvendësohen me kontinira të mbyllur me kapak.

z. Fazli Hoxha: Unë mendoj se qëllimi i ynë nuk është që të bëjmë një prezantim të mirë të këtij raporti, por qëllimi kryesor është që të kemi ambient të pastër dhe të nxjerrim mangësitë të cilat shërbejnë për përmirësim të gjendjes, sepse kemi disa vende shumë të pa pastërta siç është pjesa prapa “Viva Fresh Store”, si dhe pjesa prapa zyrave të PDK-së, ku jam i sigurt që nuk pastrohet një herë në dy javë, pra mendoj që ka shumë vonesa dhe mangësi, e qëllimi im nuk është që të sulmoj askënd por që të kontribuoj në përmirësimin e gjendjes. Unë jam angazhuar dhe e kam siguruar një projekt ku 15 persona do të angazhohen në kuadër të ndërmarrjeve publike me pagesë, që do të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes. Sugjeroj që të formohet një komision që të bëjë përmirësimin e gjendjes faktike, të bëjë hartimin e një plani të veprimit në mënyrë që të kemi punë konkrete e jo raporte të bukura dhe arsyeshmeri.

znj. Hana Zeka: DEMOS-i ka qenë i fokusuar ne hartimin e dokumenteve strategjike ne sektorin e mbeturinave dhe komuna e Gjakovës është një nder komunat qe ka përfituar më se shumti për hartimin e këtyre dokumenteve, ku është hartuar plani lokal i menaxhimit të mbeturinave ne të cilin janë të përshkruara te gjitha veprimet e komunës, në hartimin e sektorëve dhe veprimet tjera pasuese, DEMOS-i, ka ndihmuar komunën edhe ne projekte te tjera, ne sektorin e menaxhimit të mbeturinave, si ne identifikimin e deponimeve ilegale te mbeturinave, implementimin e udhëzimit administrativ, organizimin e trajnimeve ne Slloveni lidhur me largimin e deponimeve ilegale të mbeturinave.

Kryesuesi: Sa i përket gjobave mandatare qe u potencua nga znj. Zeka komuna e Gjakovës i ka te rregulluara me rregulloret komunale, mirëpo nga qeverisja e kaluar nuk janë implementuar siç duhet këto gjoba dhe te gjithë jemi ne dijeni për gjendjen ne fshatra ku mbeturinat nuk janë mirë te trajtuara.

z. Bekim Jupa: Lidhur me punën e Çabratit ne trajtimin e mbeturinave unë kam disa vërejtje sepse kjo ndërmarrje është ndërmarrje publike komunale dhe funksionon ne bazë te ligjit mbi ndërmarrjet publike dhe ligjit mbi shoqëritë tregtare, ku komuna është aksionar 100 %, u cek se komuna i ka ndihmuar ne disa projekte sidomos me vendosjen e kamerave, mirëpo kamerat nuk i kryen punët ne teren, por duhet te angazhohen Drejtoria e Inspektoratit se bashku me Drejtoritë tjera dhe Policinë qe të dalin në teren dhe të gjobitin personat juridik dhe fizik qe hedhin mbeturinat. Ne Rekën e Keqe funksion një kompani qe është komplet ilegale edhe pse punën e bën për çdo lavdat, por kërkoj qe këtë punë ta krye Çabrati e jo kompanitë ilegale. Gjithashtu dua te ceki qe gjendja e mbeturinave ne qytet nuk është e mirë dhe për këtë fajet i ka Çabrati, gjithashtu kemi ankesa të vazhdueshme nga banorët e lagjes tek Gjykata ne Gjakovë sepse aty janë të vendosura makineria e Çabratit te cilat kundërmojnë erë te pa durueshme sidomos ne stinën e verës.

Znj. Florentina Gjergjaj: Unë kam një pyetje lidhur me grandin e GIZ-it se çfarë shume ka qenë dhe çfarë vlere ka pasur ai grand, nëse është përfituar dhe sa është rritur vlere e kompanisë pas përfitimit te këtij grandit dhe pyetja tjetër është se çfarë keni ndërmarrë lidhur me deponinë ilegale afër fshatit Palabardh qe te qon për rrugën ne Radoniq, cilat janë hapat qe janë ndërmarrë.

z.Agon Batusha: Ndërmarrja Çabratit ka raportuar vazhdimisht mirëpo nuk kemi pasur një raport te këtillë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

z.Shkumbin Kastrati: Komuna e Gjakovës ka përfituar nga DEMOS-i ne dy fusha ne menaxhimin e mbeturinave dhe ne investimet për menaxhimin e mbeturinave, janë ndërtuar parqet ku pjesë e parqeve kanë qenë edhe trajtimet e mbeturinave dhe me tutje kemi vërejtur se kemi me shumë nevojë për ndërtimin e rrugëve dhe i kemi i orientuar mjetet financiare me shumë nga projektet e rrugëve dhe te rreth rrotullimeve. Unë kam punuar për fuqizimin e Çabratit edhe pse mendimi im personal është se duhet privatizuar, mirëpo për shkak të numrit të punëtoreve kemi bërë përpjekje qe ta përkrahim këtë ndërmarrje. Qendra transfer e mbeturinave është pronë komunale dhe ne kohen e ish qeverisjes komunale të z.Pal Lekaj është investuar ne vlerë prej 40 mijë euro, mirëpo për një vit është dalë nga përdorimi për shkak të keq menaxhimit dhe aty ka tri herë me tepër mbetje sa qe ka kapacitet kjo qendër, sepse Çabrati nuk është ne gjendje te absorbojë prurjet dhe dërgimin për ne Landovic. Ne jemi përpjekur të bëjmë zgjidhje për këtë çështje dhe i kemi 3 vendime të kuvendit qe ofrojnë zgjidhje mirëpo nuk janë implementuar ende për dhënien e pronës ne shfrytëzim dhe dy here është anuluar konkursi për dhënien e pronës komunale ne shfrytëzim.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kaloj për diskutim në mbledhjen e radhës së Kuvendit, nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

Përfundim

- I. Aprovohet Informata mbi menaxhimin e mbeturinave.
- II. Ky përfundim së bashku me materialin dhe dokumentin e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës

Kryesuesi: Për piken e katër të rendit të ditës e kemi Informatën për ndriçimin publik mirëpo meqenëse drejtori i Shërbimeve Publike u detyrua të tërhiqet për shkak të takimit me Ministrinë e Ambientit po e diskutojmë Informatën Financiare për periudhën Janar Mars 2018 dhe pastaj vije një zyrtar nga kjo drejtori dhe na prezanton Raportin për ndriçimin publik.

z. Bekim Jupa: Unë propozoj që kjo pikë të kalohet për diskutim në mbledhjen e kuvendit dhe aty mundem të diskutojmë për të gjitha çështjet rreth kësaj pike pasi që drejtori u detyrua që të tërhiqet për shkak të takimit zyrtar që kishte dhe nuk kemi arsyeje që mos ta kalojmë këtë pikë.

Kryesuesi: Për këtë pikë do të vjen zyrtarja për ndriçimin publik dhe do ta bëjë prezantimin, ndërsa ne po vazhdojmë me piken e radhës.

4. Pika e katërt e rendit të ditës: Informata e parë Financiare Janar - Mars 2018

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës prezantimin do ta bëjë z. Gani Rama për arsyeje se drejtori i drejtorisë për buxhet dhe financa për momentin nuk është prezent për arsyeje objektive, andaj e ftojme z. Gani Rama që t'j bëjë prezantimin e informatës së parë financiare janar-mars 2018.

z. Gani Rama: Prezantimi i informatës financiare është obligim ligjor, ne ju kemi dorëzuar dokumentin e parë përmes adresës elektronike, vonesa është bërë për shkak se dje e kemi marrë raportin përfundimtar nga Ministria e Financave dhe sot e kemi shpërndarë në tavolinat e juaja. Informata financiare komunale për periudhën janar-mars 2018, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor, në bazë të dispozitave të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe statutit të komunës. Informata financiare komunale periodike ka për qëllim informimin objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve, sipas burimeve të përmbushjes së obligimeve të planifikuara si mbas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore. Buxheti i miratuar nga Asambleja Komunale për vitin 2018 është 23.266.602,53 €, i cili ka pësuar ndryshime gjatë periudhës janar-mars 2018, për të hyrat nga donacionet dhe participimet në vlerë prej 115.395,42€. Buxheti i përgjithshëm periodik për këtë periudhë është 23.381.997,95 €. Gjatë kësaj periudhe janë alokuar mjete prej 6.467.751,68 €, ndërsa janë shpenzuar 73% e këtyre mjeteve, gjatë kësaj periudhe janë paguar borxhet e qeverisë së kaluar rreth 1 milion euro, mjetet vetanake të grumbulluara në këtë periudhë janë 748.895,46 €, që përben 98,02 % të planifikimit periodik, ndërsa krahasuar me vitin paraprak 2017, kemi rritje prej 17.97%.

z. Bekim Ermeni: Meqenëse kjo është një informatë atëherë unë po kërkoj informatë shtesë lidhur me atë se jemi dëshmitar të angazhimit të një numri të madh të resurseve humane për nevojat e kësaj qeverisjeje, dhe këtu nuk po e shoh se sa është kostoja e këtyre angazhimeve dhe si paguhen këta persona që të prezantohet kjo informatë në mbledhjen e kuvendit, si dhe me bëri përshtypje tek të hyrat vetanake, ku kemi diku rreth 2048 % rritje tek shndërrimi i tokës bujqësore në tokë jo bujqësore, ku janë grumbulluar rreth 15 mijë € dhe në krejt vitin kanë qenë të planifikuara këto mjete andaj kërkojmë sqarime për këtë çështje dhe të na prezantohen në mbledhjen e kuvendit.

z. Gani Rama: Unë dua të cekim se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar Drejtoria e Bujqësisë ka pasur realizim 17.400€, që do të thotë rreth 3 mijë euro ka pasur realizim me të madh të të hyrave,

ndërsa ne në këtë vit për 3 muaj i kemi realizuar 14.000 €, pra ne kemi realizuar vetëm 83 % krahasim me vitin paraprak ndërsa vitin 2017 ka pasur shumë me shumë të realizuar 17 mijë, po flasim për muajin Janar- Mars.

z. Agon Batusha: Unë dua te ju drejtohem me një pyetje z. Gani Ramës, pasi që nuk e kam te qartë, dua te di se si është e mundur 2,75 cent ndërtimi i rrugës Mazrek – Shishman këtë pyetje e kam bërë edhe vitin e kaluar.

z. Gani Rama: Ato lista që janë te cekura me numër 7 janë mjete të participimit që i kemi pasur për qytetarët dhe është një gabim, por duhet që përmes Asamblesë me e rregulluar atë, ky projekt është nga mjetete e qytetarëve bashkëfinancim, e pasi ato janë donacion nuk guxon që ti shfrytëzon askush ato, që do te thotë te gjitha ato pra që janë me 7 janë mjete që kanë mbetur, pra këto duhet te futen ne Asamble ose përndryshe duhet me i thirr komunitetin na dhe me i thënë a po na i falni 2 cent, pra është problem, dua te ceki se ne me Ministrinë jemi dakordu që gjitha këto projekte duhet ti fusim ne Asamble komunale te cilat janë kryer me arsyetim si mjetet e fshatit apo lagjes, kush i ka participu të shfrytëzohen për qëllime tjera pasi që kjo pjesë është kryer dhe ju jeni ata që duhet me marrë një vendim për të gjitha ato projekte që janë me vlerë 1 cent, 2 cent, 5 euro apo 10 euro.

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kaloj për diskutim në mbledhjen e radhës së Kuvendit, nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P e r f u n d i m

I. Aprovohet Informata e parë Financiare e Komunës së Gjakovës për Periudhën Janar - Mars 2018

II. Ky përfundim të përcillet për diskutim në mbledhjen e radhës së Kuvendi të Komunës

5. Pika e pestë e rendit të ditës : Informate mbi ndriçimin publik

Kryesuesi: Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Informate mbi ndriçimin publik edhe pse kemi probleme në këtë sektor sidomos tek borxhet e trashëguara mirëpo kjo pikë është e paraparë në Planin e Punës së Kuvendit dhe e ftoj zyrtaren znj. Elhamije Kumnova që të merr fjalën.

znj. Elhamije Kumnova: Buxheti për ndriçimin publikë është i vogël Komuna e Gjakovës është e përgjithësi e ndriçuar mbi 79% për këtë ndriçim janë 189 njësor në tërë komunën të ndriçimit publik andaj edhe kërkesat për mirëmbajtje dhe investime janë shumë të mëdha, kemi një kontratë të vazhduar me 30 % të kontratës dhe ndriçimi është mirëmbajtur vazhdimisht probleme kemi nga dëmtimi i rrjetit nga të reshurat si dhe problem kryesor është ndërrimi i rrjetit edhe i shtyllave nga KEDS-i që nuk e bëjnë lidhjen e ndriçimit dhe llambat i zbret në tok e nuk u vendos përsëri ky është një shqetësim i madhe për ne. Në lagjen e Qabratit e tërë linja e ndriçimit është jo funksionale nga KEDS-i që i ka ndërruar shtyllat dhe rrjetin e rrymës, mirëpo ne jemi duke e rehabilituar atë pjesë por kemi edhe probleme dhe ngecje sidomos kur kemi të bëjë me kabllot nëntokësore.

z. Bekim Jupa: U cek se në lagjen e çabratit kemi dëmtime të jashtëzakonshme të rrjetit, andaj kërkoj sqarime KEDS-i kur të kryen punën e vet a nuk është e obliguar ta kthej në gjendjen e më pareshe këtë rrjet të ndriçimit publik dhe pse nuk e kthen.

znj. Elhamije Kumnova: Ne kemi kërkuar nga DUMM që kur të lëshohen pëlqimet për punime të KEDS-it të kushtëzohet me kthimin në gjendje të mëparshme, mirëpo kur kemi të bëjmë me përcues të zhveshur nuk mundet ti kthejnë sepse duhet të jetë me përcues të ri për arsye të shtyllave të betonit .

z. Haxhi Sejdiu; A keni marrëveshje me shkrim me KEDS-in që kur të kryhen këto punime ta kthejnë rrjetin e ndriçimit në gjen dje të më parëshme .

z. Agon Batusha: Shtyllat janë të KEDS-it por toka është e Komunës andaj k jo kompani është private, andaj unë mendoj se duhet të kem i një marrëveshje që kur të kryhen këto punime mos një zyrtar i Komunë të jetë prezent që mos ti lejoj dëmtimin e këtyre kabllove .

Kryesuesi: Me sa kemi informata Komuna ka shumë borxhe në ndriçimin publik dhe në këtë periudhë nuk ka pasur mirëmbajtje të rrejtët të ndriçimit dhe vlera që është e paraparë duke e pasur parasysh edhe borxhet është e pa përballueshme.

z. Bekim Jupa: Nga informatat e më hershme kemi informata se buxheti i paraparë për vitin 2018 për Ndriçime publike është shpenzuar komplet, andaj si po vepron si po veproni ju .

znj. Elhamije Kumnova Për të gjitha këtë polem të ndriçimit lidhur me mjetet financiare mundet drejtori të ju sqaroj me hollësisht

z. Fazli Hoxha : Unë kamë qenë në një takim me rajonin e rekës së Keqe dhe Fshati Shishman ishte kombet në terr si qëndron problemi pse nuk rregullohet .

Kryesuesi: Meqenëse nuk ka diskutime e qes në votim që kjo pikë të kaloj për diskutim në mbledhjen e radhës së Kuvendit, nga anëtarët e pranishëm të KPF-së unanimisht u votua pro. Pas votimit të bërë, Komiteti nxori këtë:

P ë r f u n d i m

I. Aprovohet Informate mbi ndriçimin publik në Komunën e Gjakovës

II. Ky përfundim të përcillet për diskutim në mbledhjen e radhës së Kuvendi të Komunës

7.Pika e gjashtë e rendit të ditës : Të Ndryshme

Kryesuesi: E hapi diskutimi për këtë pikë të rendit të ditës a ka dikush ndonjë diskutim . Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur këtë mbledhje

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 12:10

Procesmbajtës,

Burim Bajrami

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shala